

# **RAPORTI I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2026, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, TË REALIZUAR NGA AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

*Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.*

## **1.Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, veprimtaria e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në fushën e njoftimit dhe konsultimit publik është karakterizuar nga përfundimi i procesit legjislativ të një akti të rëndësishëm në fushën e identitetit digjital, konkretisht miratimi i ligjit nr. 51/2026 “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”.

Procesi i konsultimit publik për këtë projektligj është zhvilluar gjatë vitit 2025, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për njoftimin dhe konsultimin publik, përmes publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK), publikimit në faqen zyrtare të AKSK-së dhe organizimit të takimeve konsultative me grupet e interesit.

Procesi i konsultimit ka kontribuar në rritjen e cilësisë së akteve të hartuara nëpërmjet marrjes së komenteve dhe sugjerimeve, në identifikimin e çështjeve praktike të zbatimit dhe në forcimin e transparencës dhe besimit ndërmjet institucionit dhe palëve të interesuara. Sfida kryesore ka qenë kompleksiteti teknik i akteve dhe nevoja për kapacitete të specializuara lidhur me hartimin e këtyre akteve. Gjatë periudhës së raportimit nuk janë zhvilluar procese të reja konsultimi publik për akte të tjera ligjore apo nënligjore.

## **2.Analiza e konsultimeve të kryera**

### ***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

#### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është miratuar 1 akt ligjor, përkatësisht:

- Ligji nr. 51/2026 “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”.

#### *2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

Gjatë periudhës së raportimit nuk janë zhvilluar konsultime të reja publike. Ligji nr. 51/2026 “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” është miratuar gjatë vitit 2026, ndërsa procesi i konsultimit publik për këtë akt është realizuar gjatë vitit 2025.

#### *2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Projektligji “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” është konsultuar gjatë vitit 2025 dhe është shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR).

#### *2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Nuk ka pasur raste të përdorimit të përgjashtimeve nga konsultimi publik gjatë periudhës së raportimit.

#### *2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Struktura e akteve të miratuara që iu nënshtruan konsultimit publik është 1 (një) projektligj.

#### *2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

AKSK ka vijuar të zbatojë standardet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar zhvillimin e konsultimeve në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

## **2.2. Metodatat e konsultimit**

*2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e përdorura për konsultimin e projektligjit, të zhvilluara gjatë vitit 2025, kanë qenë:

- Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK);
- Publikimi në faqen zyrtare të AKSK-së;
- Takime konsultative me grupet e interesit;
- Komunikimi nëpërmjet postës elektronike dhe shkresave zyrtare.

Projektligji “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” është publikuar në RENJK gjatë periudhës 3.6.2025 – 30.6.2025, si dhe është konsultuar përmes takimeve me grupet e interesit të organizuara në datat 26 dhe 27 qershor 2025.

*2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda e konsultimit që gjeneroi numrin më të madh të komenteve është publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), pasi përmes kësaj metode janë marrë shumica e komenteve të dërguara nga palët e interesit me email, ndërsa nga takimet konsultative nuk janë përcjellë komente me shkrim apo përmes emailit.

*2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Jo, institucioni nuk ka realizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit të projekt akteve.

**2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Procesi i konsultimit për projektligjin është zhvilluar gjatë vitit 2025 dhe ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh pune të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

### *2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për aktet e publikuara në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJK) ka qenë 20 ditë pune.

### *2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Situata paraqet përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, si në respektimin e afateve, ashtu edhe në planifikimin e procesit.

## **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

### *2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Projektligji është hartuar nga AKSK.

### *2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Nuk ka pasur.

### *2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Në procesin e konsultimit të projektligjit kanë marrë pjesë:

- institucione publike;
- subjekte private që operojnë në fushën e TIK-ut;
- ofrues të shërbimeve të besuara;
- ekspertë individualë;
- operatorë dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e identitetit digjital dhe shërbimeve elektronike.

Në takimet konsultative të zhvilluara gjatë vitit 2025 kanë marrë pjesë rreth 46 persona.

#### *2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Në procesin e konsultimit publik, struktura e kontribuesve përbëhej nga institucione publike, persona juridikë dhe ekspertë individualë. Konkretisht, në konsultime morën pjesë institucione publike, subjekte private që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), ofrues të shërbimeve të besuara, operatorë dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e identitetit digjital dhe shërbimeve elektronike, si dhe ekspertë individualë me ekspertizë në fushat përkatëse. Pjesëmarrja e kësaj game të gjerë kontribuesish mundësoi marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga aktorët kryesorë të prekur nga projektligji, duke kontribuar në përmirësimin e përmbajtjes së tij.

#### *2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se, krahasuar me vitet e mëparshme, niveli i pjesëmarrjes në proceset e konsultimit është përmirësuar. Kjo evidentohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga AKSK.

### **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

#### *2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Për projektligjin “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” janë paraqitur gjithsej 125 komente.

#### *2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Nga totali i komenteve të ardhura:

- 4 komente janë pranuar plotësisht;
- 1 koment është pranuar pjesërisht;
- 120 komente janë refuzuar;

Analiza e komenteve të refuzuara gjatë procesit të konsultimit publik tregon se arsyet e mospranimit të tyre lidhen kryesisht me nevojën për të garantuar përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin kombëtar dhe acquis të Bashkimit Evropian, respektimin e objektivit dhe fushës së rregullimit të projektaktit, si dhe ruajtjen e koherencës juridike dhe teknike të dispozitave të propozuara. Në këtë kuadër, komentet e refuzuara janë grupuar sipas arsyeve kryesore të refuzimit, si më poshtë:

- 30 komente u refuzuan, pasi propozimet binin ndesh me Rregulloren (BE) 2024/1183 (eIDAS 2) ose me acquis të Bashkimit Evropian,
- 22 komente u refuzuan, pasi çështjet e ngritura nuk përbënin objekt rregullimi të projektaktit ose rregulloheshin nga legjislacion tjetër në fuqi,
- 23 komente u refuzuan, pasi çështjet e propozuara janë lënë të rregullohen në aktet nënligjore të cilat do të jenë në përputhje me aktet zbatuese të Komisionit Evropian,
- 21 komente u refuzuan, pasi propozimet ishin tashmë të reflektuara në projektakt ose kërkonin përsëritjen e dispozitave ekzistuese,
- 10 komente u refuzuan, pasi projektakti përcaktonte tashmë qartë kompetencat e institucioneve përgjegjëse dhe nuk justifikohet ndryshimi i tyre,
- 14 komente u refuzuan, pasi propozimet binin ndesh me strukturën, logjikën rregullatore ose me standardet teknike të parashikuara për zbatimin e projektaktit.

Rezultatet analitike të procesit të administrimit të komenteve dhe sugjerimeve janë pasqyruar edhe në raportet individuale të konsultimit publik.

### *2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Tendenca e viteve të fundit dëshmon konsolidimin e praktikave të konsultimit publik në AKSK, ku proceset e konsultimit të zhvilluara në vitin 2025 kanë prodhuar rezultate konkrete gjatë vitit 2026, përmes miratimit të ligjit nr. 51/2026 "Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital". Për rrjedhojë, megjithëse gjatë periudhës së raportimit nuk janë zhvilluar konsultime të reja, vlerësohet se ndikimi i konsultimeve të mëparshme ka qenë pozitiv dhe i qëndrueshëm në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit.

### *2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR) është përditësuar për të reflektuar informacionin dhe të dhënat e marra gjatë procesit të konsultimit publik.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### *2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Raporti individual i konsultimit publik për projektligjin “Për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital” është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK).

#### 2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyt?

Nuk ka raporte të pa publikuara.

#### 2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c.

AKSK vlerëson se procesi i konsultimit publik për projektligjin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke garantuar transparencën, aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

#### 3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore lidhen me kompleksitetin teknik të akteve, nevojën për kapacitete të specializuara dhe përfshirjen më të gjerë të publikut joekspert. Përfshirja më e gjërë e shoqërisë në konsultim për aktet që do të hartohet në të ardhmen. Në periudhat e ardhshme, AKSK do të vijojë të forcojë mekanizmat e transparencës dhe pjesëmarrjes publike, me qëllim rritjen e cilësisë së procesit të hartimit të politikave dhe akteve ligjore e nënligjore.